




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 13 dhjetor 2021

**Nga:** Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së  
**Për:** Z. Alpin Dogan, Drejtor Menaxhues, KEDS Sh.A  
Z. Kadri Kadriu, u.d. Drejtor Menaxhues, KOSTT Sh.A  
Z. Serhat Dinç, Drejtor Menaxhues, KESCO Sh.A



**Nr.** 693/21  
**Data** 13.12.21

**Kopje:** Z. Ferat Shala, Kryetar Komisioni për zhvillim ekonomik, tregti dhe industri  
Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë  
Z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës  
Z. Nagip Krasniqi, Drejtor Menaxhues, KEK Sh.A

**Lënda:** Shqyrtim i Jashtëzakonshëm i Të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorët e Rregulluar

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të sigurisë së furnizimit me energji elektrike, vlerëson se gjendja e furnizimit me energji elektrike është e rënduar si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare. Më qëllim të ruajtjes së sigurisë së furnizimit me energji elektrike, ZRRE në pajtim me mandatin e saj do të trajtojë gjendjen e krijuar dhe do të ndërmarr veprimet e nevojshme rregullore konform rezultateve që dalin nga procesi i shqyrtimit të jashtëzakonshëm.

Si pasojë e gjendjes së krijuar, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), më datë datë 28 tetor 2021 ka pranuar nga KESCO Sh.A kërkesën për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR), dhe respektivisht nga KEDS Sh.A kërkesën Shqyrtim të Jashtëzakonshëm e ka pranuar me datë 16 të nëntor 2021.

KEDS dhe KESCO kërkesat e tyre i kanë mbështetur në situatën e krijuar në tregun e energjisë me shumicë, ku çmimet kanë arritur nivele të larta dhe të cilat nuk pasqyrojnë tarifatat aktuale të shfrytëzimit të rrjetit, rrjedhimisht ato të konsumatorëve fundorë. Përveç rritjes së çmimeve në tregjet me shumicë të energjisë elektrike, muajve të fundit vërehet edhe një rritje enorme e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë. Kjo do të rezultonte në blerje më të larta të energjisë me shumicë për mbulimin e konsumit dhe nevojat e rrjetit. Duke qenë se prodhimi vendor nuk mund të plotësojë të gjithë kërkesën për energji elektrike, paraqitet nevoja për import, që do të tejkalojë sasinë e lejuara nga ZRRE gjatë shqyrtimit të rregullt tarifor. Importi shtesë paraqet edhe kosto shtesë për operatorët, të cilat nuk janë parashikuar në të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2021.

ZRRE është duke monitoruar në vazhdimësi situatën e furnizimit me energji elektrike, dhe nga analizat fillestare të bëra, konstaton se si pasojë e mbizotërimit të çmimeve të larta në bursa ndërkombëtare,



operatorët e rregulluar janë duke u ballafaquar me vështirësi financiare, ngase tarifat aktuale nuk mund të mbulojnë kostot që ndërlidhen me importin e energjisë elektrike, e të cilat janë jashtë kontrollit të operatorëve.

ZRRE së bashku me operatorët e licencuar dhe Ministrinë e Ekonomisë, janë angazhuar në kuadër të Task Forcës për Masat Emergjente në Rast të Krizës Energjetike, ku është analizuar situata e krijuar me çmimet e energjisë me shumicë në tregjet rajonale dhe më gjerë si dhe ekspozimin e sektorit të energjisë ndaj kësaj situatë. Grupi kishte analizuar edhe masat e ndërmarra nga shtetet evropiane dhe ato të regjionit të cilat përfshinin masa të ndryshme për subvencionimin e sektorit të energjisë nga qeveritë respektive. Grupi i Task Forcës kishte ofruar një vlerësim fillestar rreth ndikimit financiar, mirëpo ende nuk ka ndonjë mbështetje konkrete për tejkalimin e kësaj situatë me çmimet e energjisë me shumicë.

ZRRE në harmoni me argumentet e paraqitura më lartë si dhe në bashkërendim me procesin e fundit tarifor, konstaton se ka indikacione të tejkalimit të pragut të materialitetit prej 5% në të Hyrat e Lejuara Maksimale të operatorëve të rregulluar të energjisë elektrike. Andaj duke u bazuar në kornizën ligjore, ZRRE njofton të gjitha palët se hapë Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). ZRRE në kuadër të këtij procesi do të bëjë analiza dhe kalkulime të bazuara në të dhënat e disponueshme dhe do të analizojë të gjitha rrethanat e krijuara në sektorin e energjisë në lidhje me kostot e sistemit si dhe në lidhje me menaxhimin e sigurisë së furnizimit. Nga ana tjetër, paralelisht do të analizohet edhe mundësia e rishikimit të strukturës së tarifave me pakicë të energjisë elektrike, ku do të shihet mundësia e aplikimit të mekanizmave tjerë për përmirësimin e efijencës së energjisë dhe të menaxhimit të kërkesës.

Në pajtim me Rregullat e të Hyrave të operatorëve të rregulluar, OST, OSSh dhe FSHU duhet të dërgojnë të dhënat lidhur me ndikimin financiar të ngjarjes së jashtëzakonshme brenda 20 dite pune nga pranimi i këtij njoftimi.

Me respekt,

  
Ymer Fajzullahu  
Kryesues i Bordit të ZRRE

